

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Retorika dhe Argumentimi Ligjor
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	viti i 2-të, semestri i 4-të
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha/lokacioni:	Amfiteatri 1 E premte, 10:30 – 12:00
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Flamur Hyseni, Prof. Ass.
Detajet kontaktuese:	flamur.hyseni@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda "Retorika dhe Argumentimi Ligjor" synon të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të krijuar, analizuar dhe prezantuar argumente juridike në mënyrë të qartë, bindëse dhe efektive. Kjo lëndë eksploron parimet themelore të retorikës dhe argumentimit, duke përfshirë teknikat e përdorura nga profesorët e së drejtës, avokatët, prokurorët, gjyqtarët dhe ligjbërësit në kontekste të ndryshme ligjore.</p> <p>Përmes studimit të teorive klasike dhe moderne të retorikës dhe argumentimit, studentët do të analizojnë vendime gjyqësore, opinione ligjore dhe debate publike për të kuptuar ndikimin e gjuhës dhe strukturës logjike në proceset juridike. Lënda thekson rëndësinë e logos-it (logjikës), ethos-it (besueshmërisë) dhe pathos-it (emocioneve) në ndërtimin e argumenteve bindëse dhe efektin e tyre në vendimmarrjen ligjore.</p> <p>Studentët do të zhvillojnë aftësi praktike për të hartuar argumente të shkruara dhe gojore, për të identifikuar dhe shmangur fallaciet logjike, si dhe për të marrë pjesë në simulime të seancave gjyqësore (Moot Court) dhe debate akademike. Në fund të kursit, ata do të jenë në gjendje të aplikojnë teknikat e mësuara në analizën dhe formulimin e argumenteve juridike në kontekste profesionale dhe akademike.</p> <p>Lënda është e domosdoshme për studentët e drejtësisë dhe shkencave politike, si dhe për ata që synojnë karrierë në avokati, gjyqësor, ligjërimit publik ose diplomaci.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Të zhvillojë aftësitë e studentëve për të ndërtuar argumente të fuqishme juridike.</p> <p>Të analizojë rolin e retorikës në ligj dhe gjyqësi.</p>

	<p>Të forcojë aftësinë për të bindur në shkrim dhe të folur. Të përgatisë studentët për të debatuar dhe përfaqësuar raste në mënyrë efektive.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Pas përfundimit të lëndës "Retorika dhe Argumentimi Ligjor", studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptojnë konceptet bazë të retorikës dhe argumentimit ligjor <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojnë parimet kryesore të retorikës klasike dhe moderne. • Të analizojnë rëndësinë e argumentimit në procesin juridik. 2. Të krijojnë dhe të analizojnë argumente juridike të strukturuar <ul style="list-style-type: none"> • Të zhvillojnë argumente logjike, të bazuara në prova dhe praktikë ligjore. • Të identifikojnë dhe të vlerësojnë forcat dhe dobësitë e një argumenti juridik. 3. Të aplikojnë teknika retorike në të folurit dhe të shkruarit ligjor <ul style="list-style-type: none"> • Të përdorin strategjitë e logos-it (logjikës), ethos-it (besueshmërisë) dhe pathos-it (emocioneve) për të krijuar argumente bindëse. • Të shkruajnë opinione ligjore, parashtrime gjyqësore dhe ese argumentuese. 4. Të identifikojnë dhe shmangin fallaciet logjike në argumentimin ligjor <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojnë argumente të dobëta dhe të zbulojnë gabimet logjike në debatet ligjore dhe politike. • Të përdorin standardet e argumentimit të vlefshëm dhe të arsyeshëm në kontekste juridike. 5. Të zhvillojnë aftësi për debat dhe diskutim në çështje ligjore <ul style="list-style-type: none"> • Të marrin pjesë në përcjelljen e seancave gjyqësore, debatet televizive, dhe debate akademike. • Të mbrojnë një pozicion ligjor përmes argumentimit

	<p>të strukturuar dhe bindës.</p> <p>6. Të analizojnë dhe interpretojnë argumentimin në jurisprudencë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të vlerësojnë mënyrën se si gjyqtarët krijojnë arsyetimin ligjor në vendimet e tyre. • Të krahasojnë dhe kritikojnë opinione shumicë dhe opinione kundërshtuese në vendimet gjyqësore. <p>7. Të integrojnë argumentimin ligjor në praktikën profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përgatisin shkrime juridike të qarta dhe të strukturuar për përdorim profesional. • Të zhvillojnë aftësi të mendimit kritik për të zgjidhur çështje ligjore komplekse. <p>Këto rezultate të nxënies synojnë të pajisin studentët me aftësi teorike dhe praktike të domosdoshme për një karrierë të suksesshme në drejtësi, avokati, politikë, administratë publike dhe fusha të tjera që kërkojnë argumentim dhe komunikim efektiv.</p>
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Punë praktike	5	1	5
Kollokfiime, seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	10	1/10	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1/15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2	4
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	2	2	4
Totali			115

Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies do të jetë standarte, duke aplikuar veçanërisht metodën e interaktivitetit. Do të aplikohen edhe debatet dhe diskutimet në klasë, prezantimi i punimeve dhe fjalimeve nga studentët dhe diskutimi mbi
-------------------------------------	---

	çështjet e ndryshme aktuale juridike, politike dhe sociale.
Metodat e vlerësimit:	Nota përfundimtare në këtë lëndë do të përcaktohet: 10% - Pjesëmarrja aktive (nëpërmjet të diskutimeve) në ligjërata dhe në ushtrime 10% - Prezantimi gojor 10% - Një ese prej pesë faqesh e dorëzuar para prezantimit gojor (në të njëjtën temë) 30% - Kollokuiumi/prezantimi - punimi 40% - Provimi final
Literatura	
Literatura bazë:	Osman Ismaili, Flamur Hyseni, RETORIKA (ligjërata të autorizuara), Prishtinë, 2021 Steve J. Bruton, Hyrje në të Drejtën dhe Arsyetimi Ligjor, New York, 2007
Literatura shtesë:	Stefan Lukas, Arti i të folurit publik, New York, 2008 Chris Anderson, Fjalimet TED, 2016
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njoftim i studentëve me plan-programin e lëndës
<i>Java e dytë:</i>	Historia e zhvillimit të retorikës
<i>Java e tretë:</i>	Metoda Sokratike
<i>Java e katërt:</i>	Silogjizmi juridik
<i>Java e pestë:</i>	Analizimi i një rasti nga praktika gjyqësore – diskutim në klasë
<i>Java e gjashtë:</i>	Argumentimi retorik dhe Argumentimi juridik
<i>Java e shtatë:</i>	Diskutim dhe prezantime nga studentët
<i>Java e tetë:</i>	Demagogjia në fjalimet publike politike
<i>Java e nëntë:</i>	Rëndësia e fjalimit “Mantri” në retorikë, fjalime gjyqësore, fjalime politike
<i>Java e dhjetë:</i>	Rëndësia e LOGOS, ETHOS, PATOS në retorikë, fjalime gjyqësore, ligjëratë akademike, dhe fjalime politike
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Kontributi i Demostenit në retorikë, studimi i fjalimeve të tij
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Si të bëjmë paraqitje të suksesshme publike – retorike, politike dhe në analizë juridike
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Teknikat e komunikimit me publikun
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Analizim i proceseve gjyqësore të famshme, (gjyqi i Sokratit, Galileut, Abdyl Frashërit, Avni Rustemit)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përsëritje e përgjithshme e plan programit dhe përgatitje për provim

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

E gjithë puna e studentit duhet të jetë e pavarur. Studentët duhet të njihen me Kodin etik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili kërkon që të gjithë, studentët dhe personeli akademik të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik. Mashtrimi, plagjiatura, gënjeshtria dhe vjedhja janë rreptësisht të ndaluara. Të gjitha shkeljet e Kodit Etik do t'i raportohen Komisionit disiplinor.